



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

Numri i lëndës: 2023:144282

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511805

PPP.nr.27/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Ibrahim Maloku, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpuntorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës N.P. “Termokos”, Sh.a., me seli në Prishtinë, rruga “28 Nëntori”, kundër debitorit M.A nga Prishtina, rruga “.....”, H: ....., nr. ...., në çështjen juridike përmbartimore për borxh në shumën prej 481.35 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.195/23, të datës 23.05.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Arsim Bajraktari në Prishtinë, jashtë seance, me datë 27.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit M.A , ashtu që MBETET NË FUQI urdhri për lejimin e përmbartimit numër P.nr.195/23, të datës 23.05.2023, të lejuar nga Zyra Përmbartimore-Përmbartuesi Privat Arsim Bajraktari në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Zyra Përmbartimore - Përmbartuesi Privat Arsim Bajraktari në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorës, ka lëshuar urdhër në bazë të dokumentit të besueshëm – karteles nr.014182, dt.23.05.2023, ashtu ka lejuar përmbartimin dhe ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri, t’ia paguaj kreditorit shumën në vlerën prej 481.35 euro, në emër të shërbimeve të auditimit të pasqyrave financiare të kompanisë, me kamatëvonesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, përkatësisht nga datat sipas faturave të cekura më lart e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore aq sa do të krijohen sipas tarifës së përmbartuesve privat nën kërcënim e ekzekutimit të dhunshëm, me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe pagesën e borxhit të kërkuar me para të kreditorit.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit debitori M.A , brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim. Në prapësim debitori ka theksuar se shënime të pretenduara nuk janë të sakta dhe se lidhur me këto shënime e kanë informuar në vazhdimësi kreditorën në zyre dhe me kërkesa zyrtare që ti verifikojnë këto të dhëna. Tutje ka shtuar se që nga fillimi i instalimit të ngrohjes

qëndrore, furnizimi me nxehe ka qenë i ndërprerë, pasi që banesa ka qenë e pa panuar dhe e pa mobiluar, ku për këtë ka bashkangjitur fotodokumentacion, me anë të së cilave pretendon se furnizimi me nxehe ka qenë i ndërprerë. Ka theksuar se kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga faturat e ujit dhe të energjisë elektrike ku dëshmohet se nuk është bërë asnjë shpenzim. Gjithashtu ka theksuar se gjendja faktike vërtetohet edhe nga fakti se në kutin kryesore banesa ka qenë e shkyçur nga sistemi i ngrohjes, për çka ka kërkuar nga kreditorja të vjen dhe të konstatoj se ngrohja është e ndërprerë, mirëpo e njëjta ka insistuar që ta paguaj obligimin e krijuar deri në ato momente, në mënyrë që ta ndërpresin faturimin, por që pagesën e tillë e ka refuzuar që ta bëjë për diçka që nuk e ka shfrytëzuar, ngase ngrohja ka qenë e ndërprerë, por se faturimi ka vazhduar, ndërsa kanë kërkuar vendosjen e matësit por që prapë është kushtëzuar me pagesë. Në fund ka theksuar se kërkon nga kreditorja që ta ndërpresë faturimin, t'i vendos matësin digjital, ta aktivizoj sistemin e ngrohjes i cili është i ndërprerë, si dhe ta sjellë gjendjen e faturave në zero, dhe pas vendosjes së matësit digjital dhe aktivizimit të sistemit të ngrohjes të faturoj në bazë të shpenzimeve reale.

Kreditorja ka paraqitur përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor. Lidhur me pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, kreditorja ka theksuar se prapësimi është i pa bazuar në ligj dhe në fakte dhe qëllimi kryesor i tij është prolongimi i procedurës për të mos paguar faturat e termokosit për furnizim me ngrohje. Ka theksuar se bazuar në pretendimet e debitorit se kreditori ka insistuar që të paguhet obligimet në mënyrë të të ndërprehet faturimi, duke aluduar në mos shfrytëzimin e banesës pasi që banesa është e pa banuar dhe e pa mobiluar, dhe se këto fakte i ka argumentuar debitori me faturat e ujit dhe energjisë elektrike, ku dëshmohet se nuk janë kryer shërbime, këto pretendime sipas kreditorës nuk qëndrojnë pasi që debitori ka pranuar ngrohjen dhe fatura çdo muaj dhe dihet se kreditorja nga fillimi i projektit të kogjenerimit nga dhjetori i vitit 2014 e tutje ka ofruar ngrohje 24 orë për të gjithë konsumatorët e vet pa dallim. Lidhur me pretendimet e debitorit se nuk ka borxh në shumën e kërkuar për periudhën e cekur në propozim dhe se ka bërë ankesa, kreditorja ka theksuar se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që debitori ka patur përgjigje se nuk ka bazë për zbritje. Po ashtu ka theksuar se në bazë të ankesave ekipi i kreditorës e ka vizituar banesën në fjalë, ku i është sqaruar debitorit të gjitha procedurat e rregullta për shkyqje, e po ashtu ka theksuar se ngrohja në objekt ka qenë funksionale dhe se kreditorja nuk menaxhon me pjesën sekondare në objekt dhe se për ndërprerje duhet të bëhet kërkesë zyrtare. Në fund ka theksuar se për tu mos u faturoar duhet që tek kreditorja të paraqitet kërkesë për shkyqje të cilën nuk e ka bërë debitori, por vazhdon ti pranoj shërbimet e kreditorës, pasi që faturat e rrymës dhe ujit nuk janë relevante për të mos u faturoar, kjo për faktin se faturimin kreditorja e bën në bazë të sipërfaqës ngrohëse duke u bazuar në rregulloren e ZRRE-së, për faturim pa njehsor, andaj, faturimi i debitorit është bërë duke u bazuar në sipërfaqen ngrohëse e që është 47.81 m<sup>2</sup>. Nga këto arsye ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të ekzekutohet borxhi.

Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin e saj C.A.P.nr.1557/2023, dt.19.12.2023, e ka aprovuar ankesën e parashtruar nga debitori M.A , ashtu që e ka prishur aktvendimin e kësaj Gjykate PPP.nr.371/23, dt.13.07.2023 dhe çështja është kthyer në procedim të sërishëm.

Gjykata duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, ka nxjerr konkluzionin PPP.nr.27/24, dt.07.02.2024, duke kërkuar nga kreditorja që ta përcaktoj periudhën kohore në propozimin për përmbarim për të cilën kërkohet borxhi në shumën prej 481.35 Euro, si dhe të paraqes deklarinimin me shkrim se kur kredia është bërë e kërkueshme.

Kreditorja me parashtrësën e datës 13.02.2024, e ka bërë precizimin e periudhës së kërkuar të borxhit në propozimin për përmbarim dhe atë nga data 31.10.2020 e deri me datën 30.04.2022, në vlerën prej 481.35 Euro, si dhe ka theksuar se vërejtja për pagesën e borxhit debitorit iu ka dërguar paraprakisht me datën 27.02.2023, ku pas afatit 7 ditor, është paralajmëruar debitori nëse nuk paguhet borxhi do të procedohet në përmbarim.

Parashtrësja në fjalë iu ka dorëzuar debitorit M.A me datën 12.03.2024 – fakt ky që vërtetohet nga fletëkthesa e kthyer në Gjykatë, mirëpo i njëjti deri në vendosjen e kësaj çështje juridike nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje apo kundërshtim në parashtrësën në fjalë.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të paraqitur nga kreditori, parashtrësës së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi nuk është i bazuar, nga këto arsye:

Gjykata ka vlerësuar ekstraktin nga librat afarist – kartelën nr.014182, të datës 23.05.2023 në bazë të së cilës organi përmbarues ka zbatuar përmbarimin dhe ka vlerësuar se e njëjta paraqet dokumente të besueshëm dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.2 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 të LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim.

Për më tepër Gjykata vlerëson se propozimi për përmbarim i përmbar të gjitha elementet e përcaktuara në dispozitën e nenit 38 të LPP-së, sepse propozimi përmbar kërkesën për përmbarim në të cilën me parashtrësën e datës 13.02.2024 është precizuar edhe periudha kohore për të cilën kërkohet borxhi në shumën prej 481.35 Euro dhe atë nga data 31.10.2020 e deri me datën 30.04.2022. Për më tepër është treguar dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përmbarimi, dihet kreditori, debitori, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti dhe objekti i përmbarimit. Po ashtu në rastin konkret Gjykata vlerëson se kërkesa e kreditorit kundrejt debitorit është bërë e arritshme, ngase paraprakisht iu është dërguar vërejtja për pagesën e detyrimit debitorit dhe pas mos pagesës së këtij detyrimi nga ana e debitorit, kreditori ka inicuar procedurën e përmbarimit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit dhe atë lidhur me atë se në periudhën në të cilën kërkohet borxhi tetor 2020 – prill 2022, ngrohja ka qenë e ndërprerë në banesën e tij nga kreditorja, Gjykata pretendimet e tilla i ka vlerësuar si të pa bazuara, kjo për faktin se me provat e ofruara sikurse janë ankesa e datës 04.06.2021, transaksionet e KEDS, ekstraktit nga librat afarist të ujësjellësit e datës 23.06.2023, si dhe fotodokumentacioni, nuk vërtetohet fakti se në këtë periudhë kohore, furnizimi me ngrohje në banesën e debitorit ka qenë i ndërprerë. Përkundrazi në shkresat e lëndës ekziston përgjigja nr.248, e datës 23.01.2023 e lëshuar nga kreditorja, përmes së cilës konfirmohet se ngrohja në objekt ka qenë funksionale dhe se kreditorja nuk menaxhon me pjesët sekondare të ngrohjes në objekt, ku edhe i janë sqaruar procedurat të cilat duhet ndjekur për tu shkyqur nga sistemi i ngrohjes qendrore të cilën si shërbim e ofron kreditorja.

Në prani të këtyre rrethanave gjykata vlerëson se debitori nuk ka ofruar asnjë provë të vetme konkrete që e argumentojnë faktin se ngrohja në banesën e tij ka qenë e ndërprerë në periudhën në të cilën e kërkon kreditorja borxhin, e në të cilat shkaqe thirret në prapësim, edhe pse ka pasur për obligim ti bashkëngjisë në kuptim të dispozitës së nenit 69 par. 4 të LPP-së. Për më tepër Gjykata edhe nuk ka mundur të lëshohet më shumë në këtë çështje juridike përmbarimore, meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale siç është procedura përmbarimore dhe me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejitimit të përmbarimit, duhet

kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit të besueshëm e që në rastin konkret ka qenë ekstrakti nga librat afarist – kartela nr.014182, dt.23.05.2023.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP.

Nga të lart cekurat e duke u bazuar në dispozitat e nenit 73 të LPP, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoj.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.27/24, dt.27.03.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.